



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**  
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse



Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_. 2021

**NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor shpall vend të lirë pune për:

**1 (një) Specialist/e në Sektorin e Studimeve të Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor pranë Drejtorisë së Koordinimit të Informacionit dhe Studimit të Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.**

Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë janë:

- Të jetë shtetas Shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbush kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zoterojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces në prokurori apo gjykatë;
- Të mos jetë pushuar më parë nga administrata e FSDKSH-së apo shërbimi Civil për thyerje të disiplinës a shkelje të tjera serioze;
- Diplomë e Arsimit të Lartë;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja do të jetë avantazh (dëshmi, çertifikata);
- Njohuri bazë në kompjuter;
- Aftësi komunikuese dhe pune në grup;
- Të ketë eksperiencë pune;

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentat pranë Drejtorisë së Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, **brenda datës 19.02.2021**, këto dokumenta;

- Kërkesë me shkrim për tu punësuar;
- Jetëshkrimi i plotësuar ( CV)
- Diplomë e noterizuar ( për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit);
- Diplomë Master e noterizuar;
- Listë notash e noterizuar;
- Dëshmi për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
- Çertifikatë familjare;
- Çertifikatë kompjuteri;
- Referencë pune nga vendi ose vendet e punës ku ka punuar;
- Librezën e punës (fotokopje) ;

- Kartë identiteti (fotokopje) ;
- Dëshmi penaliteti ( të datojë brenda 3 muajve të fundit);
- Raport mjekësor për aftësi në punë ( të datojë brenda 3 muajve të fundit).

**Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentat të dorëzohen në zarf të mbyllur, i cili protokollohet pranë Drejtorisë së Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.**

**Adresa:Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Rruga: “Sami Frashri” Tel. +3554223815. E - mail:info.fsdksh.gov.al Web://www.fsdksh.gov.al**